

VENDIM
Nr.245, datë 13.4.2010

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE
PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT TË OBJEKTEVE
“OFIÇINA E FILIALIT TË ISH - SIZMIKËS”, FIER, DHE “ISH-PARKU KOMUNAL”,
ELBASAN, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.226, DATË 23.4.2004 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE TË DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT RRUGOR, TË CILAT I
KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 14 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 8/a të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit njërive të qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekti “Ofiçinat e filialit të ish-sizmikës”, Fier, me sipërfaqe 1180 (një mijë e njëqind e tetëdhjetë) m², në pronësi të bashkisë Fier, t’i kalojë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

2. Objekti “Ish-parku komunal”, Elbasan, me sipërfaqe 3 937 (tre mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë) m², në pronësi të bashkisë Elbasan, t’i kalojë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

3. Pronat e përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij vendimi t’i bashkëlidhen listës së inventarit të pronave, miratuar me vendimin nr.226, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit”.

4. Pronat sipas pikave 1 e 2 të hiqen nga listat përfundimtare, që i bashkëlidhen vendimeve të Këshillit të Ministrave, përkatësisht, nr.574, datë 28.5.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të bashkisë Fier të qarkut të Fierit”, dhe nr.416, datë 11.7.2007 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të bashkisë Elbasan të qarkut të Elbasanit”.

5. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha